



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

Nënshkruhet në Bari marrëveshja e bashkëpunimit për projektin "Shokë dhe Engjëj". Kumbaro: "Kultura e kthen "periferinë" në qendër dhe emancipon Qytetin"

2018-03-07 16:20:00



Në vijim të bashkëpunimit të qendrueshëm kulturor Shqipëri-Pulia, pas përmbylljes me sukses të projekteve ArtVision dhe Bialja e Krijuesve të Rinj të Mesdheut Mediterranea18, Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro dhe Presidenti i Rajonit të Pulias Michele Emiliano, firmosën në datën 6 mars në Bari një tjetër marrëveshje kulturore dhe ekonomike për realizimin e projektit artistik "Shokë dhe engjëj" që synon ndërtimin e Parkut

të Artit në kopshtin e ish-Kinostudios për të krijuar kështu një pol të ri artistik në të ashtuquajturën periferi e Tiranës.

Në vijim të bashkëpunimit të qendrueshëm kulturor Shqipëri-Pulia, pas përmbylljes me sukses të projekteve ArtVision dhe Bialja e Krijuesve të Rinj të Mesdheut Mediterranea18, Ministria e Kulturës Mirela Kumbaro dhe Presidenti i Rajonit të Pulias Michele Emiliano, firmosën në datën 6 mars në Bari një tjetër marrëveshje kulturore dhe ekonomike për realizimin e projektit artistik "Shokë dhe engjëj" që synon ndërtimin e Parkut të Artit në kopshtin e ish-Kinostudios për të krijuar kështu një pol të ri artistik në të ashtuquajturën periferi e Tiranës.

Turi dhe Tirana janë dy qytetet nga Pulia dhe Shqipëria, që përmes fillit të filozofisë së Antonio Gramsci-t, mendimtari italian me origjinë shqiptare, jo vetëm krijojnë fabulën e Parkut të Artit "Shokë dhe Engjëj", duke rindërtuar qelinë e burgimit ku Gramsci shkroi Fletoret e famshme, por me ndërthurjen e instalacioneve të statujave të realizimit socialist të Galerisë Kombëtare të Arteve, ky projekt sjell një provokim të debatit të nevojshëm dhe ende të munguar mbi përballjen me të kaluarën tonë komuniste.

"Këto statuja, tha Kumbaro, përdorimi i të cilave ka një valencë të fortë simbolike, që janë mbuluar e zbuluar, ulur e ngritur, admiruar e përçmuar, do duhet të gjejnë një vend të lexueshëm e të hapur ndaj debatit e reflektimit, edhe për të përfaqësuar një pikë ndalese në atë që e kemi quajtur Rrugët e Kujtesës".

E di mirë, vijoi Ministria Kumbaro, që "Puna me këto vepra do të provokojë debate mbi tema delikate, por, me kurajo, janë tema të cilat duhet t'i përballim vazhdimisht, të paktën brezi im që kaloi gjysmën e jetës në diktaturë e ka detyrimin t'i hapë e t'i përballë. Por ky projekt, bashkë me oficinën e artit që synon restaurimin e makinave të vjetra të rekuizitës së Kinostudios dhe aktivizimin e artistëve të rinj, do të përtërijë edhe pëlhurën urbane të kryeqytetit duke krijuar një qendër të re arti, shoqërimi e debati por edhe atraksioni kulturor e turistik.

Kultura nuk është dhe nuk duhet të jetë vetëm prodhim e konsum i "qendrave" urbane, por një motor që e kthen "periferinë" në qendër dhe emancipon kështu Qytetin".

Projekti është bashkëfinancim i Ministrisë së Kulturës dhe Rajonit të Pulias.

Po kështu, Ministria Mirela Kumbaro dhe Presidenti Michele Emiliano dakordësuan edhe bashkëpunimin me Teatrin e Operas dhe Baletit që këtë vit do të shtrijë kalendarin e turneve edhe në teatrot e Rajonit të Pulias.

Ministria Kumbaro vizitoi edhe qelinë e Antonio Gramshit në burgun

e Turit, ose "trëndafili i Turit" e cila do të jetë një pikë simbolike e projektit "Shokë dhe ëngjëj", që lidh të shkuarë me të sotmen.